

Rreze Doli

POSEDIMI SENDIT NË BASHKËPRONËSI DHE PRONËSI TË PËRBASHKËT

Abstrakt

Në këtë punim do të paraqesim se si rregullohet posedimi i sendit ne bashkepronësi dhe pronësi të përbashkët përmes legjislacionit në fuqi. Do të analizohen, trajtohen dhe krahasohen legjislacioni vendor dhe ndërkombëtar sa i përket çështjes së posedimit të sendit nga dy ose më shumë persona sipas të drejtës së bashkëpronësisë apo pronësisë së përbashkët. Rëndësia dhe kategorizimi posedimit dhe pronësisë është i lartë në institutin e drejtës sendore, sepse këto dyja janë dhe cilësohen të drejta themelore të njeriut, ndarja e të cilave daton dhe rrjedh qysh nga e drejta romake dhe qëndron po e njëjta në të drejtat bashkëkohore duke përfshirë dhe atë vendore.

E drejta bashkëpronësisë dhe pronësisë së përbashkët krijohet mbi send të luajtshëm apo të paluajtshëm, prej të cilës lind *e drejta posedimit* që realizohet sipas marrëveshjes së arritur nga bashkëpronarët apo pronarët e përbashkët, marrëveshje për të cilën kushtet dhe mënyrat e realizimit saj parashihen me legjislacionin në fuqi dhe që do të paraqiten në vijim të punimit.

Por, që jo çdo herë apo gjithmonë të gjitha fushat rregullohen në mënyrën sa më të mirë sepse vërejmë që ka raste dhe rrethana, që nuk rregullohen fare me normat juridike apo nuk rregullohen në mënyrën e duhur dhe përmes këtij hulumtimi dëshirojmë eliminimin e këtyre çështjeve në sistemin juridik.

Fjalët kyçe: posedimi, bashkëpronësia dhe pronësia përbashkët